



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.2, datë 9/02/2024

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES
NR.SERIE 0012, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.11, DATË
12.07.2018 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,
SUBJEKTIT “AUTO-PASION” SH.A**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0012, miratuar me Vendimin Nr.11, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X= 4397374; Y= 4579750; Z= 72m (ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X= 4397463; Y= 4579766; Z= 72m (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X= 481028.0; Y= 4578933.4; Z= 72m (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=1$ l/s
 - Prurja mesatare : $Q_{mes}= 1$ l/s
 - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur: Rrjeti i kanalizimeve të zonës
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0012, miratuar me Vendimin Nr.11, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen, “leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare (Import-Eksport, shitje pjesë këmbimi për automjete)” të subjektit “Auto-Pasion” sh.a, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, Autostrada Tiranë-Durrës km.1, Mëzez, Bashkia Tiranë.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbytjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

